



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.225/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Clirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, sipas Aktgjykimit A.nr.2433/2019 të datës 29.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.446/2019 të datës 08.08.2019 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Lagja Mati 1, Rr.“Ahmet Gashi”, Prishtinë, kundër Vendimit me numër protokolli 7808 të datës 18.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, në çështjen juridike “Kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 05.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.446/2019 e datës 08.08.2019 e parashtruar nga ankuesja**
- II. Anulohet Vendimi me numër protokolli 7808 i datës 18.07.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit dhe Vendimi me numër protokolli 5613 i datës 24.05.2019 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit.**
- III. Mbetët në fuqi Aprovimi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm, i rekomanduar me Raportin Final të Komisionit Përzgjedhës të datës 04.08.2017 si dhe Akt Emërimi i datës 07.09.2017 i lëshuar për ankuesen në pozitën “Udhëheqëse e Divizionit të Autoshtokollave”, në Departamentin e Automjeteve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit.**
- IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, që brenda afatit prej pesëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të kthejë ankuesen në pozitën “Udhëheqëse e Divizionit të Autoshtokollave”, sipas Akt Emërimit të datës 07.09.2017, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, si dhe ti bëjë kompensimin e pagës nga data e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli 5613 të datës**

24.05.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit deri në zbatimin e këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit, me datë 08.08.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 3464/2019 të regjistruar me numër A.nr.446/2019, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me numër protokoli 7808 të datës 18.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, për shkak të shkeljeve të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.08.2019 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses të Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit. Ndërsa Këshilli me datë 20.08.2019, ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokoli 3673/2019 së bashku me shkresat e lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional për shkak të mos emërimit të anëtarëve nga Kuvendi i Kosovës, me ç'arsye Këshilli me shkresën me numër protokoli 4332/2019 të datës 16.09.2019, ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës së saj me numër A.nr 446/2019 të datës 08.08.2019, duke udhëzuar të njëjtën për të drejtën e ndjekjes së procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Pas këtij njoftimi, ankuesja ka hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, e cila me Aktgjykimin A.nr.2433/2019 të datës 29.03.2021, të pranuar në Këshill me datë 01.04.2021 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 16.09.2019 dhe ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos për ankesën e ankuesit të datës 08.08.2019.

Kolegji për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe për vendosje të drejtë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 3464/2019 të datës 08.08.2019 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.Prot: 7808 të datës 18.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit; Ankesën me Nr.Prot:6618 të datës 20.06.2017 të parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës; Vendimin me Nr. Prot:5613 të datës 24.05.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit; Vendimi i datës 24.08.2017 me nr.141 bashkë me raportin i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa për fillimin e rekrutimit; Autorizimin e Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike të datës 14.07.2017; Konkursin për avancim i datës 18.07.2017 i shpallur nga Ministria e Infrastrukturës për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Auto Shkollave: Regjistri i aplikacioneve të pranuar; Vendimi i datës 27.07.2017 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës; Formularin MAP-SHCK-05 për përcaktimin e kritereve për përfshirje në listën e ngushtë të datës 31.07.2017; Formulari për krijimin e listës së ngushtë; E-mail zyrtar i datës 31.07.2017; Njoftimi i

kandidatëve për testim nga përzgjedhja e ngushtë; kopja e testit me shkrim për Njoftim mbi përzgjedhjen e kandidatit; Aprovim mbi përzgjedhjen e kandidatit nga Sekretari i Përgjithshëm, Raporti final i rekomandimit nga Komisioni Rekrutues i datës 04.08.2017; E-mail zyrtar i datës 02.08.2017; Akt emërimi i datës 07.09.2017; Diploma me nr. 778 e datës 16.02.2004 e Vërtetimi i marrëdhënies së punës i datës 28.12.2017; Opinioni i Departamentit të Buxhetit në lidhje me dhënien e pëlqimit për publikimin e konkursit të brendshëm në Ministrinë e Infrastrukturës i datës 27.06.2017 ; Kërkesa për punësim për bashkë me dokumentet e kërkuara; Njoftimi i datës 08.08.2017 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokolli 3937/2017 për përzgjedhjen e kandidatit për pozitë Udhëheqës i Divizionit të Autoshkollave dhe Përgjigje në ankesë e datës 20.08.2019 me numër protokolli 3673/2019 bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses *është e bazuar, sepse:*

Nga shtjellimi i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur së Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, sipas Autorizimit të datës 14.07.2017 të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike, me datë 18.07.2017 ka shpallur Konkursin për Avancim me numër reference RN00002107 për pozitën "Udhëheqës/e i/e Divizionit për AutoShkolla".

Komisioni Përzgjedhës i emëruar sipas Vendimit Nr.6096/2017 të datës 27.07.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, pas zhvillimit të procedurës së rekrutimit me datë 04.08.2017 ka rekomanduar në Raportin Final ankuesen si kandidaten me të suksesshme me gjithsej 895 pikë.

Sekretari i Përgjithshëm ka aprovuar përzgjedhjen e ankueses si kandidate e suksesshme, dhe pas këtij veprimi Udhëheqësja e Divizionit të Personelit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit ka njoftuar ankuesen për përzgjedhjen e saj në pozitën e "Udhëheqëses së Divizionit për AutoShkolla".

Po nga shkresat e lëndës rezulton se Procedura e rekrutimit "Udhëheqës/e i/e Divizionit për Auto cili me Vendimin Nr.147/2017 të datës 24.08.2017, ka miratuar Raportin e vëzhgimit të kësaj procedurë të rekrutimit, pas vlerësimit së procedura rekrutuese është zhvilluar në pajtim me legjislacionin e shërbimit civil.

Pas këtyre veprimeve, Organi i punësimit, respektivisht Udhëheqësi me i lartë administrativ i ka lëshuar ankueses Akt Emërimin për pozitën Udhëheqëse e Divizionit të Autoshkollave, me afat të pacaktuar duke filluar nga data 07.09.2017.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, me Vendimin numër protokolli 5613 të datës 24.05.2019 ka anuluar veprimet që rrjedhin nga Konkursi për avancim me numër reference RN00002107 për pozitën "Udhëheqës/e i/e Divizionit për AutoShkolla" në Departamentin e Auto shkollave si dhe Akt Emërimin e datës 07.09.2017 të lëshuar për ankuesen në pozitën e Udhëheqëses për Autoshkolla, me arsyetimin së ankuesja nuk i plotëson të gjitha kushtet e caktuara për pozitën e zgjedhur dhe nuk posedon aftësitë, shkollimin dhe kualifikimet që janë në përputhje me natyrën e vendit të punës.

Ankuesja kundër Vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, më datë 20.06.2019, ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, ku ky i fundit me datë 18.07.2019 ka

nxjerr Vendim me numër protokollit 7808 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses, duke lënë në fuqi Vendimin me numër protokollit 5613 të datës 24.05.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit.

Ankuesja brenda afatit ligjorë përkatësisht me datë 08.08.2017 ka parashtruar ankesë kundër Vendimit me numër protokollit 7808 të datës 18.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të shkeljes së Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Me tutje deklaroi se procedura e rekrutimit "Udhëheqës/e i/e Divizionit për Auto Shkollë" është zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore sepse kjo është konstatuar edhe përmes Raportit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore Kolegji ka analizuar kriteret për pozitën e shpallur "Udhëheqës/e e/i Divizionit të Auto Shkollave", e si rrjedhojë ka konstatuar se kriteret e shpallura për këtë pozitë sipas Konkursit me numër reference RN00002107 të datës 18.07.2017 janë në pajtim me kriteret e aprovuara me Autorizimin e datës 14.07.2017 të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil (me tej DASHC) si dhe vet Formularin PDP për Përshkrimin e Detyrave të Punës pika 15, të dërguar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit në DASHC, me rastin e paraqitjes së kërkesës për aprovim të shpalljes së konkursit për pozitën e Udhëheqësit të Divizionit të Autoskollave, e mbi këtë bazë Kolegji konstaton se është respektuar Rregullorja Nr.05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 13 paragrafi 2 nën paragrafi 2.7, më të cilin është përcaktuar se: *Karakteristikat e nivelit drejtues dy (2) janë: Diplomë universitare dhe së paku pesë (5) vite përvojë pune* si dhe neni 9, 10, 11, dhe 13 i Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kritere bazë për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të AutoShkollave" sipas Konkursit të datës 18.07.2017, kanë qenë *"Diplomë Universitare: Fakultetit Juridik, Ekonomik, Inxhinier i Komunikacionit, dhe pesë (5) vite përvojë pune profesionale"*. Andaj, Kolegji për shqyrtimin e ankesave në pikëpamje të plotësimi të këtyre kërkesave nga ana e ankueses si dhe duke u bazuar në shqyrtimin e dosjes së aplikimit të ankueses, ka konstatuar se ankuesja ka Diplomë Universitare Nr.776 të datës 26.02.2004 me të cilën dëshmohet se ka përfunduar Fakultetin Ekonomik, ndërsa lidhur me përvojën e punës është konstatuar se ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit që nga data 02.07.2003, ku nga viti 2005 ushtron detyrën e Zyrtares së Lartë për Buxhet dhe Financa, ndërsa nga data 07.09.2017 e tutje ka ushtruar detyrën e U.d Udhëheqëses së Divizionit të Auto shkollave. Bazuar në këto fakte rezulton se ankuesja ka plotësuar kriteret e shpallura për pozitën në fjalë dhe së Komisioni Përzgjedhës me rastin e përzgjedhjes së ankueses ka vepruar në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përkatësisht nenin 11 paragrafi 1 me të cilin përcaktohet se: *Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve"*

Përkritazi me faktin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të AutoShkollave", në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm për shërbimin civil, Kolegji si fakt relevant me rastin e vendosjes lidhur me këtë çështje administrative vlerësoj aprovimin e kësaj procedure rekrutimi nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil përmes Vendimit Nr.147/2017 të datës 24.08.2017, i nxjerr me rastin e vëzhgimit të procedurës në fjalë, e me të cilin

është konstatuar se procedura e rekrutimit për këtë pozitë është zhvilluar në pajtim me legjislacionin për shërbimin civil.

Kolegji lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore ju referua edhe Nenit 27 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *Avancimi nga një pozitë më e ulët në pozitë më të lartë funksionale ose nga një gradë më e ulët në një gradë më të lartë brenda pozitës funksionale lejohet në bazë të: 1.1. disponueshmërisë së pozitive të lira; 1.2. plotësimit të të gjitha kushteve të caktuara për atë pozitë; 1.3. kalimit të kohës së caktuar minimale; dhe 1.4. kalimit me sukses të testimit, dëshimit të meritës, aftësive dhe kompetencës profesionale, si dhe Rregullores Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë përkatësisht nenin 9 me të cilin përcaktohet se: 1. Kriteret për avancim në karrierë të nëpunësit civil janë: 1.1. kalimi i kohës minimale në gradën e tyre ekzistuese në bazë të rregullave të përcaktuara më këtë Rregullore; 1.2. plotësimi i kërkesave profesionale dhe kualifikimet e kërkuara për pozitën përkatëse; 1.3. kalimi me sukses të testimit me shkrim dhe me gojë; 1.4. rezultatet e vlerësimit në punë të jenë: mirë, shumë mirë ose shkëlqyeshëm; 1.5. të mos jetë në procedurë disiplinore; 1.6. të mos jetë i ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore në 3 vitet e fundit; 1.7. të mos jetë iniciuar ndonjë procedurë penale. Ndërsa lidhur me kohën për avancim nenin 10 i po të njëjtës Rregullore ka paraparë se: *Koha minimale për avancim nga një gradë më e ulët në një gradë më të lartë ose nga një kategori funksionale më e ulët në kategorinë funksionale më të lartë, është 3 vite kur performanca e nëpunësit civil është vlerësuar mirë dhe shumë mirë, ndërsa 2 vite kur performanca e tij/saj është vlerësuar shkëlqyeshëm, Në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në provat e administruara të lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesja ka plotësuar kërkesat për avancim gjegjësisht ankuesja ka kaluar kohën minimale për avancim pasi që nga viti 2005 ushtron detyrën e Zyrtarit të Lartë për Buxhet dhe Financa si pozitë profesionale, ka plotësuar kualifikimet e kërkuar profesionale ashtu siç është përcaktuar me Konkursin e datës 18.07.2017, ka kaluar testin me shkrim dhe gojë, për dy vitet e fundit përkatësisht për vitin 2015 dhe 2016 ka vlerësim të shkëlqyeshëm të rezultateve të punës nga Eprori i saj i drejtpërdrejtë, dhe së në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi për masë disiplinore të shqiptuar ndaj ankueses apo se ndaj të njëjtës është iniciuar ndonjë procedurë penale.**

Në vështrim të nenit 51 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nëse akti i tillë është nxjerrë me shkelje ashtu siç është përcaktuar me nenin 52 të të njëjtit Ligj ku thuhet se: *Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo 1.7. nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit. Andaj, bazuar në rrethanat si me lartë dhe meqenëse Kolegji gjatë vlerësimit të shkresave të lëndës nuk ka gjetur ndonjë shkelje e cila procedurën e rekrutimit të zhvilluar për pozitën e "Udhëheqëses së Divizionit të Auto hollave" e bënë të paligjshme, Kolegji konstaton së Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli 5613 të datës 24.05.2019, me të cilin ka anuluar të gjitha veprimet që rrjedhin nga konkursi për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Auto Shkollave" si dhe Akt Emërimin e datës 07.09.2017, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Rregullores Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë si dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*



Po ashtu, bazuar në gjendjen faktike dhe bazën juridike të konstatuar si me lartë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave vlerëson së Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër protokolli 7808 të datës 18.07.2019, nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike lidhur me çështjen kontestuese, e mbi këtë bazë rrjedhë se pretendimet ankimore janë të bazuara.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, ashtu siç është përcaktuara ne dispozitivin e këtij vendimi, është i obliguar që të kthej ankueser në pozitën "Udhëheqëse e Divizionit të Autoshkollave", në Departamentin e Automjeteve sipas Akt Emërimit të datës 07.09.2017, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, si dhe ti bëjë kompensimin e pagës nga data e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli 5613 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit deri në zbatimin e këtij vendimi.

Bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e udalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.225/2021

Clirim ZEKA

Zyrtar për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses;
- Ministrin të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit
- Sekretarin të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit dhe
- Arkivit të KPMShCK-së